



Instalimi i llampave eficiente në qytetin e Gjilanit (projekti 2010)

Projekti është bashkëfinancuar nga MZHE-GIZ-Komunat përkatëse. Në vitin 2011 projekti është zbatuar në qytetet Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë dhe Ferizaj. Kursimi vjetor vjetor i energjisë nga projekti për qytetin e Prishtinës është 106 MWh (242 llamba eficiente të instaluar). Kthimi i investimeve bëhet për 4.3 vite.



Foto: Stacioni i autobusëve dhe Zona Industriale, Prishtinë

Kursimi vjetor i energjisë nga projekti për qytetin e Mitrovicës është 161 MWh (385 llamba eficiente të instaluar). Kthimi i investimeve bëhet për 4.4 vite.




Foto: Rr. Brigada 141, Mitrovicë

Kursimi vjetor vjetor i energjisë nga projekti për qytetin e Podujevës është 61 MWh (300 llamba eficiente të instaluar).



Foto: Rr. Zahir Pajaziti, Podujevë

Kursimi vjetor vjetor i energjisë nga projekti për qytetin e Ferizajt është 231 MWh (524 llamba eficiente të instaluar). Kthimi i investimeve bëhet për 3.3 vite



Rrjeti ndriçues para investimeve



Rrjeti ndriçues pas investimeve




Foto: Rr. Ahmet Kaçiku dhe Dëshmorët e Kombit, Ferizaj

ENERGJIA Prodhuesi Modeli	Frigorifer
Më shumë eficient	
A	
B	← B
C	
D	
E	
F	
Më pak eficient	
Konsumi i Energjisë kWh/vit (Ekskl. në pasivitet e matjeve standarde për 24 orë)	
Konsumi i energjisë do të varret nga mënyra e përdorimit të pajisjes dhe nga vendit ku do të instalohet.	
Volumi i Zonës së Frikimit - Itra	
Volumi i Zonës së Ngritjes - Itra	
Niveli i Zhurmës (dB(A) re 1 pW)	
Për më shumë informacion lexoni kataloqun e pajisjes	
Norma EN 153 Direktiva për Etiketim të Frigoriferave 2002/95/KE	

Forma e Etiketës së pajisjeve
elektrike shtëpiake



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA
VLADA /GOVERNMENT

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

DEPARTAMENTI I ENERGJISË
Divizioni i EE&BRE

Efiçienca e Energjisë (EE)



Prishtinë, 2011



I. Definicioni i Eficiencës së energjisë (EE)

Eficienca e Energjisë—është raporti në mes të vlerës së energjisë së përfutur, prodhimit e performancës së realizuar të shërbimit dhe vlerës së sasisë së energjisë së konsumuar për këtë destinim.

II. Korniza strategjike dhe programore

- Strategjia e Energjisë (2009-2018);
- Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Eficiencë të Energjisë (2010-2018).

III. Kuadri ligjor dhe rregullator

- Legjislacioni primar:

- Ligji Nr.03 / L – 184 për Energjinë;
- Ligji Nr.03 / L – 185 për Rregullatorin e Energjisë;
- Ligji Nr.03 / L – 201 për Energjinë Elektrike;
- Ligji Nr.04/ L – 016 për Eficiencën e Energjisë.

- Legjislacioni sekondar:

- Udhëzimi Administrativ për Auditim të Energjisë;
- Udhëzimi Administrativ për Promovimin e Eficiencës së Energjisë;
- Udhëzimi Administrativ për Etiketimin e Pajisjeve Elektrike Shtëpiake.

Tri udhëzimet e shënuara më lart kanë kuptimin e transpozimit të tri direktivave kryesore të BE-së për EE:

- D. 2006 /32/EC për konsumin fundor të energjisë dhe shërbimet e energjisë;
- D. 2010/31/EC për performancën energjetike të ndërtesave;
- D. 2010/30/EC për etiketimin e pajisjeve elektrike shtëpiake;

IV. Projektet e EE-së për periudhën 2010 – 2011 dhe projektet në vazhdimësi

Në periudhën kohore 2010-2011, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka zbatuar disa projekte të EE, me financa nga buxheti i shtetit, apo me bashkëfinancim, apo me forma të tjera të mbështetjes financiare nga donatorët dhe institucionet e ndryshme financiare. Në këtë kontekst, si institucione kryesore mbështetëse duhet përmendur: Komisioni Evropian (përmes Zyrës Ndërlidhëse në Kosovë (ZNKE)), mandej GIZ, WBIF etj.

Disa prej këtyre projekteve kanë karakter studiuës, ndërsa disa të tjera kanë karakter promovues e zbatues/demonstrues.

Projektet studimore dhe promovuese:

1. Studimi dhe implementimi i masave të eficiencës së energjisë në nivelet komunale(2009- 2013);
2. Studimi i stokut të ndërtesave publike për auditim të energjisë (2011);
3. Trajnimi i Auditorëve të Energjisë (2010)- Projekti është zhvilluar në dy faza:
Në fazën e parë janë trajnuar dhe certifikuar 28 auditorë të energjisë;



Ekipi i auditorëve të energjisë te objekti i Çerdhes Ardhmëria -2, Gjiilan

Në fazën e dytë janë trajnuar dhe certifikuar 23 auditorë të energjisë;



Ekipi i auditorëve të energjisë të objekti i Shkollës fillore – Migjeni, Mitrovicë

4. Projekti për zhvillimin institucional për zbatimin e rregullores për kursimin e energjisë në ndërtesa (2010);
5. Fushata për Ngritjen e Vetëdijes Publike për Eficiencën e Energjisë dhe Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (2010);
6. Fushata publike për ndriçim eficient (2010).



Projektet zbatuse/demonstruse

1. Projekti: Ndrëçimi eficient i rrugëve publike (2010-2011)

Në kuadër të këtij projekti janë ndriçuar me llamba eficiente rrugët e qendrave komunale të qyteteve:

- Prishtinë;
- Gjiilan;
- Prizren;
- Ferizaj;
- Mitrovicë;
- Podujevë.